

BULETINI

Botimi Nr.

03MUJOR **PRILL** 2026**01 PRILL**

Takim me Shoqatën e Transportit

U zhvillua një takim me përfaqësuesit e Shoqatës së Transportit, ku u diskutuan sfidat e sektorit dhe ndikimi i tyre tek qytetarët. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkinë Tiranë, po shqyrtohen kërkesat e operatorëve, ndërsa dialogu me biznesin do të vijojë për të arritur zgjidhje efektive.



01 PRILL

Skema e granteve për SME-të 2026

U miratua skema e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026, me një fond prej 100 milionë lekësh, që do të administrohet nga AIDA. Skema mbështet certifikimet, marketingun, trajnimin e stafit dhe digjitalizimin, me deri në 2.5 milionë lekë për biznes, duke nxitur konkurrueshmërinë dhe zhvillimin.



02 PRILL

Miratimi i ligjeve në Kuvend

Kuvendi miratoi një paketë ligjesh që forcojnë ekonominë dhe afrojnë Shqipërinë me standardet e BE-së, përfshirë aderimin në traktate ndërkombëtare për markat tregtare dhe simbolin olimpik, ratifikimin e marrëveshjes me Turqinë për rregullat e origjinës, si dhe ndryshime në ligjin për parqet teknologjike për nxitjen e inovacionit dhe investimeve.



03 PRILL

Takim për tregtinë elektronike dhe mbrojtjen e konsumatorit

U zhvillua një takim me grupet e interesit mbi tregtinë elektronike dhe mbrojtjen e konsumatorit, si pjesë e procesit të integrimit në BE. Po punohet për forcimin e kuadrit ligjor dhe krijimin e një agjencie të dedikuar për monitorimin e tregut dhe trajtimin e ankesave.



03 PRILL

Takim me biznesin për tregun e punës

Në Shtëpinë e Biznesit u zhvillua një takim me përfaqësues të biznesit dhe agjencie të rekrutimit për përmirësimin e shërbimeve në tregun e punës. Diskutimet u fokusuan në lehtësimin e proceseve, veçanërisht për pajisjen e të huajve me leje unike, në kuadër të përafrimit me standardet e BE-së.

DITARE E VETME PUNËSIMI



07 PRILL

Platforma “Dritare e Vetme Punësimi”

U prezantua platforma e unifikuar për vendet e lira të punës në sektorin publik, që përfshin rreth 180 institucione dhe afro 1,500 vende pune. Nisma synon të rrisë transparencën dhe aksesin e qytetarëve në tregun e punës.



08 PRILL

Vizitë në kompleks industrial në Durrës

U zhvillua një vizitë në një kompleks industrial në Durrës, ku operojnë kompani në fushën e transportit, riciklimit dhe përpunimit industrial. U theksua roli i investimeve në teknologji dhe aftësi profesionale në rritjen e pagave dhe krijimin e vendeve cilësore të punës.



08 PRILL

Dita Ndërkombëtare e Romëve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, u zhvillua një aktivitet për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komunitetit rom. U riafirmua angazhimi për politika gjithëpërfshirëse, me fokus te strehimi social dhe mbështetja financiare për familjet në nevojë.



08 PRILL

Arsimi profesional në Kavajë

Në Shkollën Profesionale “Charles Telford Erickson” në Kavajë u prezantua modeli i arsimit dual që lidh shkollën me tregun e punës. Me mbi 200 nxënës dhe bashkëpunim me 45 biznese, shkolla ofron mundësi konkrete për punësim dhe zhvillim profesional.



09 PRILL

Zhvillimi i sektorit të ndërtimit

Në Tiranë u theksua roli i sektorit të ndërtimit si motor i transformimit ekonomik dhe social. Rritja e interesit për investime në pasuri të paluajtshme, përfshirë nga diaspora, po kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.



10 PRILL

Takim me sipërmarrësit e vajit të ullirit në Berat

Në Berat u zhvillua një takim me sipërmarrës të përpunimit të vajit të ullirit për rritjen e pagave, investimet dhe mbështetjen fiskale. U prezantua edhe nisma “Dyfisho Ndërmarrjen” për financimin e bizneseve me potencial rritjeje.



11 PRILL

Vizitë në Yura Corporation Albania, Fier

U zhvillua një vizitë në kompleksin industrial të kompanisë Yura Corporation Albania në Fier. Rreth 2,000 punonjës përfitojnë nga rritja e pagës minimale, duke reflektuar ndikimin pozitiv të politikave ekonomike në punësim.



14 PRILL

Diaspora dhe inovacioni

Në Tiranë u theksua roli i diasporës si partner strategjik në zhvillimin e biznesit dhe inovacionit, duke kontribuar në rritjen e investimeve dhe shkëmbimin e njohurive.



14 PRILL

Diplomimi në arsimin profesional

U zhvillua ceremonia e diplomimit të brezit të parë të studentëve të shkollës së Hoteleri-Turizmit, të trajnuar sipas modelit të École Hôtelière de Lausanne. Programi ofron aftësi konkurruese dhe mundësi të mira punësimi në tregun europian.



16 PRILL

Vizitë zyrtare në Itali

Në Romë u zhvilluan takime zyrtare me Kryeministren Giorgia Meloni dhe Ministrin e Mbrojtjes Guido Crosetto, në kuadër të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Italisë.



17 PRILL

Takim në Barcelonë me Dhomën e Tregtisë së Katalonjës

Në Barcelonë u zhvillua një takim me Dhomën e Tregtisë së Katalonjës, ku u evidentua rritja e interesit për Shqipërinë si destinacion turistik dhe partner ekonomik, si dhe forcimi i marrëdhënieve me Spanjën.



20 PRILL

Këshilli i Investimeve dhe reforma e pronës

Në mbledhjen e Këshillit të Investimeve u diskutua siguria juridike e pronës dhe roli i saj në zhvillimin ekonomik. U theksua rëndësia e digjitalizimit dhe reformave për rritjen e transparencës dhe besimit të investitorëve.



21 PRILL

Takim ndërkombëtar për telekomunikacionin në Tiranë

Tirana mirëpriti një takim ndërkombëtar me aktorë të industrisë së telekomunikacionit, ku u diskutuan zhvillimet teknologjike dhe transformimi digjital.



22 PRILL

Memorandum bashkëpunimi Shqipëri–Greqi

Në kuadër të Delphi Economic Forum u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet AIC dhe Hellenic Corporation of Assets and Participations, për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe zhvillimin e projekteve strategjike.



23 PRILL

Investimi në Antea Cement

U prezantua një investim në Antea Cement që kombinon zhvillimin industrial me inovacionin dhe përgjegjësinë mjedisore, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe standardet europiane.



23 PRILL

Projektligji për lirinë e shërbimeve

U prezantua projektligji “Për lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve”, në përputhje me direktivat e BE-së. Ligji synon thjeshtimin e procedurave, rritjen e transparencës dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme.



23 PRILL

International Girls in ICT Day 2026

Në Piramidën e Tiranës u zhvilluan aktivitete në kuadër të International Girls in ICT Day, ku vajzat dhe të rinjtë diskutuan mbi teknologjinë, inovacionin dhe të ardhmen digjitale.



24 PRILL

Sipërmarrja e grave në Shqipëri

Në një tryezë të organizuar nga UN Women u diskutuan politikat për mbështetjen e grave sipërmarrëse, me fokus në aksesin në financë dhe rritjen e bizneseve të drejtuara nga gra.



24 PRILL

Nisma për teknologjitë kuantike (QBI)

U mbështet nisma për zhvillimin e teknologjive kuantike në Ballkan, duke synuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe avancimin e inovacionit në rajon.



24 PRILL

Dialog me studentët për integrimin në BE

Në Institutin e Studimeve Europiane u zhvillua një dialog me studentët mbi procesin e integrimit evropian dhe rolin e arsimit në këtë rrugëtim.



25 PRILL

Investim në arsimin profesional në

Peshkopi

U inspektova përfundimi i konviktit të shkollës profesionale “Nazmi Rushiti”, një investim që përmirëson kushtet për nxënësit dhe forcon lidhjen mes arsimit dhe tregut të punës.



25 PRILL

Festivali Kombëtar i Shkencës

U zhvillua finalja e Festivalit Kombëtar të Shkencës, ku nxënësit prezantuan projekte inovative dhe u ndanë çmime për arritjet më të mira në teknologji dhe kreativitet.



25 PRILL

Tryezë për reformat dhe sektorin privat

U zhvillua një tryezë diskutimi mbi agjendën e reformave për integrimin në BE dhe përgatitjen e sektorit privat, me fokus sfidat dhe mundësitë për biznesin shqiptar.



28 PRILL

Prezantimi i kursit për menaxhimin e sistemeve teknike në hoteleri

U prezantua kursi “Menaxhimi i sistemeve teknike në hoteleri”, një program që synon përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar për sektorin e turizmit. Nisma forcon lidhjen mes arsimit dhe tregut të punës, duke theksuar rolin kyç të formimit profesional në zhvillimin e sektorëve strategjikë si turizmi, energjia dhe infrastruktura.